



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 17, pika **b** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 11, paragrafi 1, pika 1.15, nenit 17 paragrafi 5, nenit 20 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 04/L -174, për planifikimin hapësinor, të nenit 7, paragrafi 2 i Udhëzimit administrativ nr.05/2014, për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1 pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.12.2016, miratoi këtë

V E N D I M

**PËR LËNIEN NË DISPOZICION PËR SHQYRTIM PUBLIK TË
PROPOZIMPLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR
BLOQET: B 17, B 18, B 19 DHE B 20, TË LAGJES "MATI 1"**

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

- 1.1. Miratohet Vendimi për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, të lagjes "Mati 1".
- 1.2. Propozimplanit nga pika I e këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

Konsultimet publike

- 2.1. Propozimplanit rregullues i hollësishëm, i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, u lihet në dispozicion për shqyrtim publik qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente, në afat prej 30 ditësh.
- 2.2. Organizimin e shqyrtimit publik të Propozimplanit, do ta bëjë Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

- 2.3. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, Projektplanin final, së bashku me një përmbledhje të shkurtër të komenteve të bëra gjatë diskutimit publik - raportin, do t'i dorëzohen Kuvendit të Komunës së Prishtinës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 3 Subjekti përgjegjës

- 3.1. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- 3.2. Organet tjera përkatëse kompetente do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij Propozimplanit, nga përgjegjësitë e tyre të parapara sipas Vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës komunale.

Neni 4 Kufiri i territorit

Zona për të cilën është hartuar Planin rregullues i hollësishëm përfshinë një sipërfaqe prej S= 21.68 Ha, e cila zonë përfshinë pjesën e zgjedhjes urbane "Kodrina" dhe një pjesë tjetër në pjesën jugore të këtij plani. Parcelat që bëjnë pjesë në këtë zonë, shtrihen në kuadër të Zonës kadastrale Matiçan.

Neni 5 Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb - faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 031-311332, më 22.12.2016

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.

ARSYETIM

I Vendimit për lënie në dispozicion të Projektplanit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, të lagjes "Mati 1"

Duke u bazuar në nenin 17, pika 1 e Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 04/L-174, dhe duke pasur parasysh kërkesat e pronarëve të tokave brenda blloqeve: B 17, B 18, B 19, B 20, të lagjes "Mati 1" dhe marrëveshjet e arritura mes tyre dhe investitorëve, Komuna e sheh të nevojshëm dhe të arsyeshëm fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, i cili plan do të inkorporohet më pas në Hartën zonale të Komunës së Prishtinës.

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e gjashtë, të mbajtur më 29.09.2016, ka marr vendim për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20 të lagjes "Mati 1" dhe vendimi është publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës.

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke u bazuar në neni 11, pika 1.6.1 e Ligjit nr. 04/L-174, përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve njerëzore të veta, ka emëruar ekipin profesional, i cili e ka hartuar Planin Rregullues të Hollësishëm, duke e inkuadruar me modifikimet e duhura edhe plotëzimin e bllokut "Kodrina".

Zona për të cilën është hartuar Plani rregullues i hollësishëm, është zonë e përcaktuar sipas Planit zhvillimor komunal, i miratuar nga Kuvendi i Komunës, me nr. 01 - 031-156871, dt. 27.08.2013 dhe sipas Planit zhvillimor urban, i miratuar nga Kuvendi i Komunës, me nr. 01 - 035 - 181427, dt. 24.09.2013. Kjo zonë gjendet brenda Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 35 - 18186, dt. 03.08.2005, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin 01. nr. 35-642, dt. 01.04.2010 dhe Vendimin 01. nr. 031 - 1678, dt. 20.07.2011.

Zona për të cilën është hartuar Plani rregullues i hollësishëm përfshinë një sipërfaqe prej $S = 21.68$ Ha, e cila zonë përfshinë pjesën e zgjidhjes urbane "Kodrina" dhe një pjesë tjetër në pjesën jugore të këtij plani (shih ekstraktet e bashkëlidhura). Parcelat që bëjnë pjesë në këtë zonë shtrihen në kuadër të Zonës kadastrale Matičan.

Plani rregullues i hollësishëm ka përcaktuar kushtet ndërtimore sipas Ligjit për planifikim hapësinor, 04/L-174 dhe Udhëzimit administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikim hapësinor mbi elementet themelore të planit rregullues, nr. 41, 02/05 (Bazuar në interpretimin e dhënë nga MMPH-ja).


Projektplani rregullues i hollësishëm është finalizuar dhe duke u bazuar në nenin 7, pika 2, të Udhëzimit administrativ për përgjegjësitë e autoritetit të planifikimit

hapësinor, si dhe Parimet dhe proceduarat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor nr. 05/2014, Komuna do ta vë draftin në dispozicion të publikut, grupeve të interesit, departamenteve dhe agjencive të tjera qeveritare për shqyrtim dhe komentim, dhe kjo periudhe do të zgjasë 30 ditë.

Pas shqyrtimit publik, Komuna do t'i shqyrtojë, analizojë dhe inkorporojë propozimet që do të rrjedhin nga debati publik dhe do ta dorëzojë Projektplanin rregullues të hollësishëm në Kuvendin e Komunës për miratim përfundimtar.



Gjendja faktike: Sipërfaqja e trajtuar, kufijtë e zonës



Gjendja faktike: Sipërfaqja e trajtuar, kufijtë e zonës